

V E N D I M

Nr.290, datë 10.6.1999

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.826, DATË 30.12.1998 "PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 30.12.1998 "Për rritjen e pensioneve", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e pleqërisë, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të cilat nuk kanë përfituar rritje të plotë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 30.12.1998 "Për rritjen e pensioneve", për shkak të kufizimit nga niveli maksimal i pensionit, do të përfitojnë diferencat nga data 1.4.1999.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.826, datë 30.12.1998 "Për rritjen e pensioneve", në pikën 2 paragrafi 2 hiqet fjalia "Pensioni maksimal mbetet 8 000 (tetë mijë) lekë."

3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga fondi i degës së pensioneve, i programuar në buxhetin e vitit 1999 për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko